



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A.nr. 77/2012

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Ymer Hoxha kryesues, Hasan Shala dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me kërkesën për tërheqjen e ankesës Anr.73/2012 e datës 28.04.2012, e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Ferizaj, në seancën e panelit të mbajtur me 30.04.2012, mori këtë:

### V E N D I M

**Konsiderohet e tërhequr ankesa** Anr.73/2012 datë 28.04.2012 e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Ferizaj.

### Arsyetim

PZAP, ka pranuar një kërkesë për tërheqje të ankesës nga subjekti politik LDK Anr.73/2012 që ishte parashtruar në PZAP më datë 28.04.2012, kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Ferizaj, me të cilën pala ankuese kërkon që mos të shqyrtohet ankesa e lartcekur, me arsyetimin se komisioni për parashtresa dhe ankesa i subjektit politik LDK, ka parë të arsyeshme që ta tërheqë ankesën Anr.73/2012.

PZAP-i pasi që shqyrtoi kërkesën për tërheqjen e ankesës Anr.73/2012, në të cilën kërkohet nga PZAP-i që mos ta shqyrtojë ankesën në fjalë, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi e nga pala ankuese, në kuptim të nenit 115.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 77/2012 më datën 30.04.2012

Kryesuesi i Panelit  
Ymer Hoxha

